



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Në bazë të Nenit 35 të Ligjit mbi Radio Televizionin e Kosovës Nr. 04/L-046, shpallë:

KONKURS

Për plotësimin e pozitës:

Drejtor i RTK 2 – TV

Drejtori i RTK 2 – TV:

- Drejtori i Kanalit RTK 2 - TV duhet të jetë person me përvojë të gjerë të menaxhimit të medieve apo fushave të tjera relevante;
- Drejtori i Kanalit RTK 2 - TV duhet të jetë shtetas i Kosovës dhe me vendbanim të përhershëm në Kosovë;
- Drejtori i Kanalit RTK 2 - TV përzgjidhet dhe emërohet nga Bordi i Drejtorëve, përmes konkursit publik duke marrë në konsiderim rekomandimin e Grupit Punues për Përzgjedhjen e Drejtorit të Kanalit Televiziv në gjuhën serbe.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Menaxhon veprimtarinë e Kanalit RTK 2 - TV në pajtim me Ligjin e RTK-së, Statutin e RTK-së, dhe Kodin Etik të RTK-së;
- Administron dhe menaxhon Kanalin RTK 2- TV, duke siguruar funksionim efektiv dhe efikas;
- Përgatit planin vjetor programor, i cili përmban vëllimin edhe strukturën e programit dhe është në përputhje me mundësitë financiare të RTK-së;
- Përgatitë raportin vjetor mbi përmbushjen e planit programor për nivelin e shikueshmërisë së programit televiziv, posaçërisht për emisionet e reja;
- Planifikon, organizon dhe mbikëqyr procesin e punës në njësinë programore të Kanalit RTK 2- TV;
- Është përgjegjës për transmetimin e programit në tërësi si dhe për transmetimin e reklamave sipas kornizës ligjore;
- Mbikëqyrë përmbushjen e planit programor me numër minimal të ekzekutuesve;
- Mbikëqyrë arsimimin dhe zhvillimin e kadrove të reja me perspektivë;
- Zhvillon bisedat e rregullta vjetore në njësitë programore;
- Udhëheqë dhe përfaqëson njësitë programore të Kanalit RTK 2- TV;
- Përgatitë normativat dhe standardet programore;
- Përgatitë strategjitë zhvillimore për njësitë programore të Kanalit RTK 2- TV;
- Siguron cilësinë e programit sipas strukturës së programit të përcaktuar me ligj;
- Përcjellë menaxhimin e mjeteve financiare për çdo emision, duke përlllogaritur çmimin për një minutë të programit;
- Organizon përpilimin dhe nënshkruan të gjitha dokumentet mbi afarizmin financiar të njësisë programore të Kanalit RTK 2 – TV, përfshirë edhe pagesën e punës me honorar;
- Përgatitë emisionet e reja me shkallën paraprakisht të përcaktuar të shikueshmërisë;
- Vlerëson shikueshmërinë dhe statistikat programore;
- Mbikëqyrë arkivimin e materialit programor;
- Kryen punë të tjera sipas kërkesës së Drejtorit të Përgjithshëm.

I punësuari për punën e vet në cilësinë e Drejtorit të Kanalit RTK 2 – TV i përgjigjet dhe i raporton Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së.

Kushtet që duhen plotësuar:

1. Kualifikim superior profesional në drejtimin përkatës;
2. Të paktën 5 vjet përvojë pune në menaxhimin e mediave apo fushave të tjera relevante (Përparësi kanë kandidatët me përvojë më të gjatë);
3. Të jetë person me integritet të lartë personal dhe moral;
4. Të ketë njohuri të shkëlqyeshme të spektrit medial në Kosovë, regjion dhe më gjerë;
5. Të ketë aftësi të dëshmuara në organizim, udhëheqje dhe planifikim;
6. Aftësi udhëheqëse dhe komunikuese;
7. Standard të lartë të gjuhës serbe në të folur dhe në të shkruar;
8. Njohje të gjuhës shqipe dhe të gjuhës angleze;
9. Aftësi për caktimin e prioriteteve dhe për të punuar në mënyrë efikase nën presion;
10. Të mos ketë dëshmuar përkatësi partiake;
11. Njohuri e programeve MS Word, Excel dhe të tjera;
12. Aftësi për të bashkëvepruar me maturi dhe ndjeshmëri me kolegë dhe palë;
13. Përkushtim ndaj shërbimit publik të transmetimeve.

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- a. një CV,
- b. një certifikatë të lindjes,
- c. një kopje të letërnjoftimit,
- d. një letër motivuese,
- e. tri referenca,
- f. dëshmitë e kualifikimit,
- g. dëshmi që nuk është nën hetime, si dhe
- h. aplikacionin, i cili duhet të shkarkohet nga web faqja e RTK-së, www.rtklive.com.

Bashkëngjitur me këtë dokumentacion, kandidati duhet të dorëzojë edhe një projekt lidhur me synimet zhvillimore të Kanalit RTK 2 - TV (deri në 3 faqe).

Dorëzimi duhet të bëhet personalisht në kuvertë të mbyllur në ndërtesën e RTK-Televizionit, rr. Xhemajl Prishtina nr.12 Prishtinë, Republika e Kosovës, në zyrën e Administratës nr. 71.

Për shkresat e pranuar, do të dorëzohet konfirmimi i pranimit.

Data e fundit e pranimit të aplikacioneve është 28.05.2019, ora 16:00.

Aplikacionet e dërguara me vonesë nuk do të pranohen.

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.